

VENDIMI
Nr. 353, datë 16.6.2021

**PËR SHPRONËSIMIN PËR INTERES PUBLIK TË PRONARIT TË PASURISË
SË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKET NGA REALIZIMI I
PROJEKTIT “SISTEMIM, ASFALTIM I RRUGËS ‘ALLAMANI’, FUSHË-KRUJË”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës; të neneve 5, 20 e 21, të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik”, të ndryshuar; të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin për interes publik të pronarit të pasurisë së paluajtshme, pronë private, që preket nga realizimi i projektit “Sistemim, asfaltim i rrugës ‘Allamani’, Fushë-Krujë”.

2. Shpronësimi të bëhet në favor të Bashkisë Krujë.

3. Pronari i pasurisë së paluajtshme, pronë private, që shpronësohet, të kompensohet në vlerë të plotë sipas masës përkatëse që paraqitet në tabelën bashkëlidhur këtij vendimi, për pasurinë e llojit tokë “truall”, me një vlerë të përgjithshme prej 918 241 (nëntëqind e tetëmbëdhjetë mijë e dyqind e dyzet e një) lekësh.

4. Vlera e përgjithshme e shpronësimit, prej 918 241 (nëntëqind e tetëmbëdhjetë mijë e dyqind e dyzet e një) lekësh, të përballohet nga buxheti i miratuar i Bashkisë Krujë.

5. Shpenzimet procedurale, në vlerën 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë, të përballohen nga buxheti i miratuar për Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë, për vitin 2021.

6. Shpronësimi të fillojë menjëherë pas botimit të këtij vendimi në Fletoren Zyrtare dhe afati i përfundimit të shpronësimit të jetë 3 (tre) muaj pas datës së hyrjes në fuqi të tij.

7. Pronari i pasurisë së paluajtshme, pronë private, i pasqyruar në tabelën që i bashkëlidhet këtij vendimi, të kompensohet, për efekt shpronësimi, pasi të ketë paraqitur certifikatën e pronësisë, kartelën e pasurisë, si dhe hartën treguese të regjistrimit, pranë Bashkisë Krujë.

8. Bashkia Krujë të kryejë procedurat për likuidimin e pronarit të shpronësuar, sipas përcaktimeve të bëra në këtë vendim.

9. Afati i fillimit dhe i përfundimit të punimeve të jetë në përputhje me afatet e parashikuara nga Bashkia Krujë.

10. Agjencia Shtetërore e Kadastrës, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e miratimit të këtij vendimi, në bashkëpunim me Bashkinë Krujë, të fillojë procedurat për hedhjen e gjurmës së projektit mbi hartën kadastrale të regjistrimit, sipas planimetrisë së shpronësimit të miratuar dhe të bëjë kalimin e pronësisë për pasuritë e shpronësuar në favor të Bashkisë Krujë.

11. Agjencia Shtetërore e Kadastrës të pezullojë të gjitha transaksionet me pasuritë e shpronësuar deri në momentin kur do të realizohen procesi i hedhjes së gjurmës së projektit mbi hartën kadastrale të regjistrimit dhe kalimi i pronësisë në favor të Bashkisë Krujë për pasurinë e shpronësuar.

12. Ngarkohen Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Bashkia Krujë dhe Agjencia Shtetërore e Kadastrës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Erion Braçe

Lista e pronarëve të pasurive, pronë private, që shpronësohen nga realizimi i projektit “Sistemim, asfaltim i rrugës ‘Allamani’, Fushë-Krujë”

N r.	Emër, Mbiemër	Lloji i pasurisë	ZK	Nr. i pasurisë	Sip. totale m ²	Sip. e shpronësuar m ²	Çmimi lekë/m ²	Vlera totale në lekë	Shënime sqaruese
1	Irbana Fatbardh Ziri	Truall	1664	1/398	400	328.53	2795	918,241	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
Vlera totale paraprake								918,241	

Shënim.

1. Vlerësimi i pasurisë së llojit “truall”, është kryer bazuar në VKM-në nr. 89, datë 3.2.2016.